



REPUBLIKA E KOSOVËS

REPUBLIKA KOSOVA

REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT

OPŠTINA LIPLJAN

MUNICIPALITY OF LIPJAN

DREJTORIA KOMUNALE E ARSIMIT

DATE /A	10.07.2025
REFERENCË	
PËR:	z. Imri Ahmeti, Kryetar i Komunës në Lipjan
CC:	z. Diamant Bytyqi, Nënkyetar i Komunës në Lipjan
NGA:	z. Rasim Hasani, Drejtor i Drejtorisë së Arsimit në Lipjan
LËNDA:	Raport i punës – Muaji Qershor 01.06.2026-30.06.2026

PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME E RAPORTIMIT

Gjatë muajit Qershor DKA ka realizuar punë dhe aktivitete të ndryshme brenda kompetencave të veta.

PUNËT DHE AKTIVITETET E REALIZUARA (IMPLEMENTUARA) GJATË PERIUDHËS RAPORTUESE

Përfundimi i gjysmëvjetorit të dytë për klasat **9,10** dhe **11** më datë **05/06/2026**.

Përfundimi i gjysmëvjetorit të dytë për parafillor dhe klasat **1-8** më datë **19/06/2026**.

Mbajtja e testit të arritshmërisë **26.06.2025**, test të cilit ju kanë nënshtuar **961** semimaturantë.

Mbajtja e testit të Maturës Shtetërore me **20/06/2025**, test të cilit ju kanë nënshtuar **855** maturantë.

Mbajtja e ditës së shkollës në:

- Shfmu “Zenel Hajdini” në Gadime shënon 100 vjetorin e Shkollës
- Shfmu “Ibrahim Banushi” në Shalë
- Shfmu “Ibrahim Krasniqi” në Smallushë dhe
- SHML “Ulpiana” në Lipjan

Me mbështetje të Komunës së Lipjanit, Shfmu “Vëllezërit Frashëri” në Lipjan në ditën e shënimit të shkollës ka organizuar mbajtjen e panairit **P-GJASHTË (Gjuhës, artit dhe shkencës dhe Teknologjisë)**. Pjesë e këtij panairi ishin të gjitha shkollat e mesme të ulëta publike dhe private nga Komuna e Lipjanit, ku vlen të theksohet se pjesë e panairit ishin edhe shkollat pjesëmarrëse nga Komuna e Prishtinës, Podujevës si dhe Komuna e Drenasit.

Panairi në fjalë ka pasur karakter edukativ, social, rekreativ dhe garues.

- Furnizimi i IEA me lëndë djegëse-dru.
 - Furnizimi i shkollave me material didaktik, material të mirëmbajtjes etj.
 - Impementimi i kontratës “Rregullimi i pllatos në hyrje të shkollave në Lipjan” ka dështuar për arsye të moskryerjes së punëve nga operatori i kontraktuar.
- Konform kësaj është bërë shkëputja e kësaj kontrate.

Zotimet në kategorinë mallra & shërbime dhe komunali.

Kërkesë DP-së për zhvillimin e procedurës për:

- Kërkesë për rishpalljen e procedurës së prokurimit:Furnizimi i çerdheve dhe shkollave me inventar – Kontratë dy vjeqare
- Kërkesë për shitjen e prodhimeve bimore grurit përmes ankandit publik

Përgatitja e formularëve të personelit arsimor dhe dërgimi i tyre në MSHP dhe atë:

- Formular për ndryshime-kthimi nga lehonja, kalimi në pushim lehonie, shtimi i licencimit, shtimi i përvojës,
- Formular për largim-skadim kontrate, pensionimi,
- Formular për punëtor të rinjë,
- Të ndryshme-ndërrimi i xhirollogarisë.

Pranimi dhe shqyrtimi i kërkesave të ndryshme (kërkesa për punësim, pushim mjekësor, pushim lehonie etj).

DISKUTIME PUBLIKE (Takime me qytetarë)

- Takim me Kolegjiun për Arsim.
- Takime me drejtor të shkollave rreth qështjeve që ndërlidhen me procesin edukativo-arsimor.

SFIDAT

- Risistemimi i punëtorëve arsimor të cilët humbin normat për shkak të zvogëlimit të numrit të nxënësve dhe mbylljes së paraleleve të ndara fizike
- Rritja e numrit të rasteve të fëmijëve me nevoja të veçanta në shkolla, si pasojë e kësaj komisioni për vlerësimin e këtyre fëmijëve e ka të pamundur t’i vlerësoj të gjithë në kohë reale.
- Nevoja për angzhimin e asistentëve për nxënës me nevoja të veçanta ose realizimi i munësisë për angazhimin e tepricës së mësuesve që mbesin pa vend pune në pozitën e asistentëve.

REKOMANDIMET

- Angazhimi i drejtorëve të shkollave për një organizim sa më të mirë të procesit edukativo-arsimor dhe

ÇËSHTJE TJERA

Të gjitha punët e realizuara janë cekur në raport dhe nuk ka ndonjë çështje tjetër për të elaboruar. DKA do të punoj vazhdimisht për krijimin e kushteve sa më të mira në të gjitha shkollat e Komunës sonë, duke menduar gjithmonë më të mirën për të gjithë nxënësit.